



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 24.06.2022**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1541\_2022**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25 dhe Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085); dhe
- Dispozitat e Nenit 8.1 të Kodit të Matjes.

në seancën e mbajtur me datë 24.06.2022, nxori këtë:

## **VENDIM**

**I. MIRATOHET dokumenti “Rregulla për Zhvillimin e Profileve Karakteristike të Ngarkesave në Sistemin Energjetik në Kosovë”**

### **Arsyetim**

Sipas Ligjit Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike, Rregullatori në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe me Zyrën e Ndhmës Shtetërore, së paku çdo dy (2) vite duhet të kryejë hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

Rregullatori, konform kërkesave ligjore ka kryer vlerësimin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, ku ndër të tjera është konstatuar se, ndikim në konkurrencë të ulët në treg ka edhe mungesa e qasjes së furnizuesve në informata të mjaftueshme rreth profilit të ngarkesës së konsumatorëve të energjisë elektrike në Kosovë.

Të dhënat për profilet karakteristike të ngarkesës mundësojnë palëve të bëjnë një planifikim më të mirë të kërkesës, humbjeve, konsumit të konsumatorëve, të cilat ndikojnë në kalkulime më të sakta të jobalanceve si dhe përmirësimin e alokimit korrekt të kostove sipas konsumit të grupeve të konsumatorëve për përcaktimin e nivelit të tarifave për shfrytëzuesit e sistemit të shpërndarjes, poashtu në planifikimin dhe zhvillimin e rrjetit, etj.



Databaza e krijuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për profilet karakteristike të ngarkesave në sistemet elektroenergjetike mundëson që furnizuesit me energji elektrike të kenë çasje në informata për profilin e konsumit të energjisë të konsumatorëve, duke mundësuar që tregu i energjisë elektrike të jetë më konkurrues.

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të dokumentit konsideron se dokumenti plotëson kriteret e nevojshme për kryerjen e obligimeve të përshkruara në rregull dhe është në harmoni me legjislacionin e sektorit të energjisë në Kosovë, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nixirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare Rregullatorit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.

**Bashkëngjitur:** "Rregulla për Zhvillimin e Profileve Karakteristike të Ngarkesave në Sistemin Energjetik në Kosovë"

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i ZRRE-së:

  
Ymer Eejzullahu, Kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar